

Koordinatori Kombëtar Antitrafik

Buletin Informativ

Nr. 10

Maj – Gusht

2016

Takim i Koordinatorëve Kombëtarë të Evropës Juglindore 12 maj 2016, Tiranë



Më 12 maj 2016, në Tiranë u zhvillua për herë të parë në vendin tonë takimi i Koordinatorëve Kombëtarë për Luftën kundër Trafikimit të Personave nga vende të Evropës Juglindore si: Bullgaria, Kroacia, Moldavia, Bosnje Hercegovina, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Kosova dhe Sllovenia.

Ky takim u organizua nga Ministria e Punëve të Brendshme/Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim dhe me

mbështetjen financiare të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe ICMPD-së “International Centre for Migration Policy Development”.

Në takim ishte i pranishëm Ambasadori i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, SH. T. Z. Florian Raunig, Komisioneri i Mbretërisë së Bashkuar për çështjet e trafikimit, Z. Kevin Hylan, përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë, të ICITAP, të Organizatës Ndërkombëtare IOM dhe Terre des Hommes, si dhe përfaqësues të OSBE-së dhe ICMPD-së në Vjenë.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi sfidat e hasura në identifikimin e fëmijëve të pashoqëruar në vendet e Evropës Juglindore, mbi masat e marra për mbrojtjen/asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, mbi zbatimin e procedurave për identifikimin dhe referimin e grupeve vulnerabël në nivel

kombëtar dhe ndërkombëtar, mbi mënyrat e forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në rajon e më gjerë.

Të gjithë pjesëmarrësit në takim prezantuan masat që kanë marrë në lidhje me situatën e fëmijëve të pashoqëruar, nismat e mundshme ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore dhe vendeve të tjera jashtë rajonit për të adresuar problematikat e fëmijëve të pashoqëruar dhe atyre që kanë lidhje me çështjet e trafikimit nëpërmjet indikatorëve të njehsuar.

Zëvendësministrja e Punëve të Brendshme, bëri një prezantim të zhvillimeve më të fundit në vend për luftën kundër trafikimit të personave dhe fëmijët e pashoqëruar, duke e vënë theksin tek bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar, hartimi i një plani të

përbashkët pune për vitin 2016 për adresimin e fenomenit të fëmijëve të pashoqëruar, gjetja e zgjidhjeve efikase të problematikave mes vendeve të burimit, tranzitit dhe destinacionit, nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta bilaterale dhe trilaterale, si dhe ngritja e rrjetit të Koordinatorëve Kombëtarë të Evropës Juglindore.

•••

*Trajnimi “Puna ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri
13, 17, 31 maj, 3 qershor në Fier, Durrës, Elbasan dhe Vlorë,*

Më 13, 17, 31 maj, 3 qershor 2016, në Fier, Durrës, Elbasan dhe Vlorë, u zhvilluan trajnimet me temë “Puna ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri”. Në këto trajnime morën pjesë përfaqësues të Njësive për Mbrojtjen e fëmijëve, të shërbimit social shtetëror, të shëndetësisë, arsimit, sektorit të trafikeve, shoqatave që operojnë në këto qarqe, gazetarë, etj.

Çdo trajnim u realizua në dy pjesë: në pjesën e parë, përfaqësues të organizatës Terre des Hommes dhe pjesëmarrësit diskutuan mbi format dhe mënyrat e bashkëpunimit, procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në situatë rruge dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal.

Ndërsa, në pjesën e dytë, pjesëmarrësit u ndanë në fokus grupe me qëllim identifikimin e nevojave dhe hartimin e planit lokal për fëmijët në situatë rruge. Të pranishmit evidentuan si kategori në rrezik trafikimi: komunitetin rom dhe egjiptian, fëmijët në situatë rruge, personat me aftësi ndryshe dhe fëmijët me çështje të kujdesit social (jetim, prindër të divorcuar). Për secilën nga këto kategori, pjesëmarrësit, të ndarë në grupe, dhanë argumentet e tyre për analizimin e situatës dhe menaxhimin e rastit. Problematikat e fëmijëve në situatë rruge nuk mund të zgjidhen veçmas nga ato të trafikimit, prandaj, punonjësit e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve, gjatë punës së tyre në terren, duhet të identifikojnë jo vetëm fëmijët në situatë rruge, por edhe

viktimat e mundshme të trafikimit. Për të theksuar rëndësinë që kanë punonjësit e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit, përfaqësues të Drejtorisë së Antitrafikut realizuan një prezantim në secilin takim, mbi identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit, bazuar në Procedurat Standarde të Veprimit.

Pas një procesi të gjerë konsultimesh dhe rekomandimesh nga aktorët lokalë që trajtojnë problematikat e fëmijëve në përgjithësi dhe, të fëmijëve në situatë rruge në veçanti, do të hartohet dhe nënshkruhet plani lokal i veprimit për fëmijët në situatë rruge për bashkinë Fier, Durrës, Elbasan dhe Vlorë.

•••

*Shpërndarja e certifikatave për trajnimin mbi Procedurat Standarde të Veprimit
19 maj 2016, Tiranë*



Ministria e Punëve të Brendshme/Zyra e Koordinatorit Kombëtar në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) dhe në bashkëpunim me të gjithë aktorët e përfshirë në identifikimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, mbështetur nga ekspertiza e anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës, përgjatë periudhës shkurt –prill 2016, zhvilluan 12 trajnime me përfaqësues të strukturave shtetërore dhe organizatave joshtetërore, në 12 qarqet e vendit.

Me qëllim rritjen e njohurive dhe sensibilizimin e aktorëve lokalë lidhur me detyrat institucionale për identifikimin, referimin dhe ndihmën ndaj viktimave të trafikimit, vendosjen dhe forcimin e kontakteve ndërinsticionale, mbledhja e informacionit mbi situatën e trafikimit në vend dhe sugjerimet lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të Procedurave Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të referimit u trajnuan në të gjithë vendin 388 profesionistë të strukturave të ndryshme dhe, konkretisht:

173 punonjës të strukturave të Drejtorive Vendore të Policisë, komisariateve dhe drejtorive të kufirit dhe migracionit;
67 inspektorë të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
65 punonjës të sistemit arsimor, mësues, psikologë dhe punonjës socialë;
22 punonjës të drejtorive rajonale të shërbimit social shtetëror;
16 punonjës të sistemit shëndetësor;
22 punonjës të Njësive për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjës të bashkive;
23 përfaqësues të qendrave pritëse dhe riintegruese dhe OJF-ve që operojnë në qarqe.
Në datë 19 maj 2016, Zëvendësministria e Punëve të Brendshme dhe njëkohësisht Koordinatore Kombëtare për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, Zj. Elona Gjebrea Hoxha, në mjediset e Gardës së Republikës, organizoi një ceremoni për shpërndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit që ishin pjesë e trajnimit në Tiranë.



Workshop rajonal “Mbi implementimin e legjislacionit të BE-së për Kapitullin 24 në fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të migrantëve”

8-10 qershor 2016, Shkup, Maqedoni



Në datat 8-10 qershor 2016, në Shkup, Maqedoni u zhvillua workshopi rajonal mbi implementimin e legjislacionit të BE-së për Kapitullin 24 në fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të migrantëve.

Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i përvojave, ekspertizës dhe praktikave më të mira për zbatimin e legjislacionit të BE-së në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.



Në këtë workshop morën pjesë përfaqësues nga Ministrinë e Punëve të Brendshme të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si: Shqipëria, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Gjithashtu në takim, u ofrua edhe mbështetje me ekspertë nga vendet anëtare të BE-së në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

•••

*Workshop multi-institucional “Takim pune shumë-agjenci për Mekanizmin Kombëtar të Referimit dhe praktikat e mira në fushën e ndjekjes penale, hetimit dhe politikave gjyqësore”
28-29 qershor 2016, Tiranë*



Në datat 28- 29 qershor 2016, u zhvillua ëorkshopi multi-institucional “Takim pune shumë-agjenci për Mekanizmin Kombëtar të Referimit dhe praktikat e mira në fushën e ndjekjes penale, hetimit dhe politikave gjyqësore”.

Aktiviteti pati në fokus paraqitjen e një grupi shumë disiplinor të raportit të ICMPPD, referuar edhe raporteve ndërkombëtare, mbi mekanizmat antitrafikim në Shqipëri, shkëmbimin e praktikave më të mira në fushën e ndjekjes penale, hetimit proaktiv dhe praktikave gjyqësore, shkëmbimin e eksperiencave në përmirësimin e aftësive teknike të ekspertëve për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse për viktimat e trafikimit, si dhe forcimin e lidhjeve mes zbatuesve të

ligjit, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile të përfshirë në mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Në këtë takim 2 ditor, mori pjesë Zëvendësministrja e Punëve të Brendshme/Koordinatori Kombëtar për Çështje të Luftës Kundër Trafikimit të Personave, Zj. Elona Gjebrea Hoxha, si dhe përfaqësues nga policia, Prokuroria për Krime të Rënda, organizatat kombëtare e ndërkombëtare, KKSAT, ZKKA, prokurorë të rretheve dhe OPGJ.

Zj. Elona Gjebrea Hoxha në fjalimin e saj, pasi falenderoi të gjithë të pranishmit për prezencën e tyre e cila ndihmon për të bashkëpunuar më mirë për sa i përket Mekanizmit Kombëtar të Referimit, dhe për të ndjekur praktikat më të mira në fushën e ndjekjes penale, hetimit dhe politikave gjyqësore.

Në fjalën e saj Zj. Gjebrea, theksoi:

“Do të doja të falënderoja në fakt të gjithë organizatorët e këtij aktiviteti. Dëshiroja që të shprehja dhe falënderimet dhe mirënjohjen që Qeveria Shqiptare ka ndaj Bashkimit Evropian, për ndihmën e vazhdueshme ndaj Shqipërisë në rrugën e forcimit të demokracisë dhe konsolidimit të shtetit të së drejtës.

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian mbetet një nga prioritet kryesorë të Qeverisë Shqiptare. Ne jemi tërësisht të angazhuar të përmbushim të gjitha detyrimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për të arritur me sukses këtë objektiv.

Pritshmëritë e këtij aktiviteti i kemi të mëdha, pasi na duhet të forcohet më shumë puna e hetimeve dhe e të gjithë politikave gjyqësore. Jo më kot sot fjala e ditës është “reforma në drejtësi”. Ne mendojmë se pikërisht kjo reformë do sjellë një përmirësim të legjislacionit penal të Procedurës Penale, një bashkëpunim dhe trajtim më të mirë të viktimave të trafikimit dhe të të drejtave të njeriut, sikurse dhe rritje të hetimeve e procedimeve të suksesshme.”

•••

*Takim i anëtarëve të MKR-së
30 qershor 2016*

Në datë 30 qershor 2016 u organizua Tryeza e Rrumbullakët me anëtarët e Mekanizmit Kombëtar të Referimit ku u diskutua mbi finalizimin e planit të Punës për periudhën në vazhdim, si dhe mbi procedurat e aplikimit pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

•••

Takim trilateral mes autoriteteve shqiptare, malazeze dhe kosovare për zbatimin e Protokolleve të Bashkëpunimit për Identifikimin, Referimin dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.
6 korrik 2016, Tiranë



Më datë 6 korrik 2016 u zhvillua takimi trilateral mes autoriteteve shqiptare, malazeze dhe kosovare për zbatimin e Protokolleve të Bashkëpunimit për Identifikimin, Referimin dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.

Pala shqiptare u përfaqësua nga Zëvendësministrja e Punëve të Brendshme /Kordinator Kombëtar për Çështje të Luftës Kundër Trafikimit të Personave, Zj. Elona Gjebrea Hoxha.

Autoritetet shtetërore, grupet e punës së tre shteteve respektive dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë kundër trafikimit të qenieve njerëzore diskutuan përgjatë dy ditëve mbi hartimin e një plani të përbashkët pune për fëmijët në lëvizje, unifikimin e formateve të identifikimit, referimit dhe vlerësimit për viktimat/viktimat e

mundshme të trafikimit dhe intensifikimin e bashkëpunimit në zbatim të protokolleve të bashkëpunimit.

•••

Takime mbi përmirësimin e hetimit të rasteve të trafikimit të personave

Korrik 2016

Shkodër, Vlorë, Korçë

Gjatë muajit korrik, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Tiranë, organizoi 3 takime, në Shkodër, Vlorë dhe Korçë mes punonjësve të policisë vendore dhe prokurorëve të Prokurorisë për Krime të Rënda për të diskutuar mbi problematikat e hasura gjatë hetimit të veprave penale trafikimit të personave. Në të tre takimet punonjësit e policisë kërkuan sugjerime në lidhje me interpretim ligjor dhe hetimin e veprave si trafikimi dhe shfrytëzimi i personave, nga prokurorët. NJë nga shqetësimet e ngritura ishte edhe shfrytëzimi i fëmijëve për lypje vepër e cila vazhdon të hetohet vetëm kur raportohet nga agjencitë e mbrojtjes sociale. Mungesa e shërbimeve të mbrojtjes dhe stigma lidhur me stilin e jetesës së komunitetit rom, u përmendën si faktorët kryesorë për mos ngritjen e akuzave penale kundër

prindërve ose të tjerëve që shfrytëzojnë fëmijët për lypje. Prokurorët kërkuan që të gjitha rastet e dyshuara të trafikimit të personave dhe shfrytëzimit të punës së fëmijëve t'i referohen Prokurorisë për Krime të Rënda, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

•••

UN Gift Box
30 korrik 2016, Durrës



Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me rrjetin e organizatave URAT, Stop the Traffik dhe UN Gift, nën kujdesin e Zëvendësministres së Punëve të Brendshme Zj. Elona Gjebrea Hoxha, më datë 30 korrik 2016, realizuan hapjen e fushatës verore për ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave nëpërmjet implementimit të projektit të UN GiftBox i cili është implementuar tashmë dhe në disa vende të tjera të botës, përpara sheshit të bashkisë Durrës. Kjo ditë gjithashtu, përkoi me Ditën Botërore Kundër Trafikimit të Personave.



Zëvendësministrja e Punëve të Brendshme/Koordinatorja Kombëtare për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, përshëndeti këtë iniciative e cila gjithashtu do të implementohet gjatë këtij viti edhe në disa qytete të tjera të vendit, dhe gjatë fjalës se saj i bën thirrje të gjithë qytetarëve të telefonojnë në numrin falas 116006 për të raportuar çdo rast apo shqetësim në lidhje me trafikimin e personave ose të raportojnë në aplikacionin "Raporto! Shpëto!" i cili mund të shkarkohet nga Google Play.

Gjithashtu prefekti i Durrësit Z. Rolant Xhelilaj, përshëndeti këtë projekt i cili realisht është mjaft i nevojshëm në këtë periudhë të vitit në qytetin e Durrësit pasi fluksi i turistëve në këtë vend, rrit dhe mundësinë e zhvendosjes së fëmijëve apo personave të cilët shfrytëzohen për lypje në këtë qytet. Të ftuarit, firmosën gjatë këtij takimi Deklaratën simbolike "Thuaj Jo Trafikimit" e cila tregon mbështetjen e organizmave shtetërore, jo shtetërore, organizatave dhe

qytetarëve ndaj kësaj nisme.



...

Bashkëlidhur këtij buletini do të gjeni Anex 1, ku janë pasqyruar statistikat mbi rastet e trafikimit maj-gusht 2016...



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Zyra e Koordinatorit Kombëtar

Adresa : Sheshi: "Skënderbej", nr. 3,

Tiranë

Shqipëri

Tel & Faks: 00355 4 223 3540/539

e-mail: koordinator.kombetar@punetebrendshme.gov.al

<http://www.punetebrendshme.gov.al/al/antitrafiku>

Anex 1

Statistika mbi rastet e trafikimit për periudhën maj-gusht 2016

∅ Të dhëna statistikore nga sektori kundër trafikëve të paligjshme (Policia e Shtetit)

NR.	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCAVE	Evidentuar	Autorë të veprave penale				
			Gjithsej	Masa sigurimi			
				Arrestuar	Ndaluar	Gjykim i Lirë	Larguar
1	Trafikimi i personave	13	9	0	0	9	0
2	Trafikimi i te miturve	9	9	0	1	3	1

☞ Të dhëna statistikore mbi VT/VmT të identifikuara gjatë periudhës maj-gusht 2016

Të dhëna mbi VT/VMT identifikuar gjatë periudhës Maj-Gusht 2016	Statusi	
	19 VT/VMT	
	VT	VMT
	4	15
	Mosha	
	Të rritur	Fëmijë
	9	10
	Seksi	
	M	F
	2	17
	Kombësia	
	Shqiptar	Të huaj
	17	2

☞ Të dhëna statistikore për çështjet penale nga Gjykata e shkallës së parë Për Krime të Rënda

